MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë

Data: 31.12.25 Nr.: 01-2518

| | |
|---|---|
| **DATË/A** | 2025 |
| **REFERENC-Ë** | 01 |
| **PËR/ZA/TO:** | Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU)- Hajrije Morina – Drejtoreshë e ARRU-së, z. Abedin Azizi- Zv.Drejtor i ARRU |
| **NGA/OD/FROM:** | Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A.- Bashkim Kurti - Kryeshefi Ekzekutiv |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Plani i Menaxhimit të Aseteve (PMA) |

Me anën e kësaj shkrese ju dërgojmë Planin e Menaxhimit të Aseteve (PMA) i KRU "Mitrovica" Sh.A.

Me respekt,

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI SH.A
REGIONALNI VODOVOD D.D
MITROVICA
2
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C

MITROVICA
KOMPANIA RAJONALE SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNE VODOVOD D.D.

# PLANI I MENAXHIMIT TË ASETEVE

## KRU "Mitrovica" SH.A - Mitrovicë

Mitrovicë, tetor 2025

# 1. Përmbajtja


1. Hyrje .....
2. Deklarata e nivelit të shërbimeve ..... 1
3. Menaxhimi i aseteve dhe metodologjia ..... 1
   3.1. Përfitimet nga Menaxhimi i Aseteve ..... 1
   3.2. Korniza Ligjore ..... 1
   3.3. Metodologjia e vlerësimit të aseteve ..... 1
      3.3.1. Shërbyeshmëria e aseteve ..... 1
      3.3.2. Kritikaliteti i aseteve ..... 1
4. Gjendjes ekzistuese e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura ..... 1
   4.1. Shërbimet e ujësjellësit ..... 1
      4.1.1. Zona e shërbimit dhe numri i konsumatorëve ..... 1
      4.1.2. Burimet e ujit ..... 2
      4.1.1. Impiantet e përpunimit të ujit ..... 2
      4.1.2. Sistemet e dezinfektimit ..... 3
      4.1.3. Stacionet e pompimit ..... 3
      4.1.4. Rezervuarët e ujit ..... 3
      4.1.5. Valvulat e ujit ..... 4
      4.1.6. Valvulat kontrolluese të rrjetit të ujësjellësit ..... 4
      4.1.1. Ujëmatësit në prodhim ..... 4
      4.1.1. Ujëmatësit e konsumatorëve biznes, industri dhe institucione ..... 5
      4.1.2. Ujëmatësit e konsumatorëve shtëpiak ..... 5
      4.1.3. Ujëmatësit zonal ..... 5
      4.1.4. Hidrantët ..... 5
   4.2. Shërbimet e ujërave të ndotura ..... 5
      4.2.1. Zona e shërbimit dhe numri i konsumatorëve ..... 5
      4.2.2. Pusetat e kanalizimit ..... 6
      4.2.3. Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura ..... 6
5. Menaxhimi i të dhënave ..... 6
   5.1. Shërbimet e ujësjellësit ..... 6
      5.1.1. Asetet infrastrukturore ..... 6
   5.2. Asetet jo-infrastrukturore ..... 7

5.3. Shërbimet e ujërave të ndotura ..... 7
5.3.1. Asetet infrastrukturore ..... 7
6. Mirëmbajtja dhe rritja kapitale ..... 7
6.1. Mirëmbajtja kapitale ..... 7
6.2. Rritja kapitale ..... 7
7. Planifikimi financiar ..... 7
8.Konkluzionet ..... 8

## Lista e tabelave

**Tabela 1.** Deklarata e nivelit të shërbimeve ..... 1
**Tabela 2.** Përshkrimi mbi vlerësimin e rangimit të probabilitetit të dështimit të asetit ..... 1
**Tabela 3.** Vlerësimi i aseteve infrastrukturore (nëntokësore) - Ujësjellës ..... 1
**Tabela 4.** Vlerësimi i aseteve infrastrukturore (nëntokësore) – Kanalizim ..... 1
**Tabela 5.** Numri i konsumatorëve sipas Komunave për vitin 2024 ..... 1
**Tabela 6.** Burimet ujore ..... 1
**Tabela 7.** Impiantet e përpunimit të ujit ..... 2
**Tabela 8.** Karakteristikat për secilën komponent/ hap të përpunimit të ujit ITU "Shipol" ..... 2
**Tabela 9.** Karakteristikat për secilën komponent/ hap të përpunimit të ujit ITU "Balincë" ..... 2
**Tabela 10.** Lista e pajisjeve në FPU Shipol ..... 2
**Tabela 11.** Stacionet e pompimit ..... 3
**Tabela 12.**Stacionet e pompimit që nuk janë në menaxhim të KRU"Mitrovica" ..... 3
**Tabela 13.**Rezervuarët e ujit ..... 3
**Tabela 14.**Rezervuarët e ujit që nuk janë nën menaxhimin e KRU"Mitrovica"sh.a ..... 3
**Tabela 15.**Valvulat operuese në Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj ..... 4
**Tabela 16.**Valvulat e ajrimit Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj ..... 4
**Tabela 17.** Valvulat për redukimin e shtypjes së ujit në Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj ..... 4
**Tabela 18.**Ujëmatësit në prodhim ..... 4
**Tabela 19.**Numri i konsumatorëve ..... 4
**Tabela 20.**Numri i konsumatorëve biznes, institucione ..... 4
**Tabela 21.**Numri i konsumatorëve shtëpiak me dhe pa ujëmatës ..... 5
**Tabela 22.**Ujëmatësit zonal në Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj ..... 5
**Tabela 23.**Numri i konsumatorëve (kanalizim) sipas komunave për vitin 2024 ..... 5
**Tabela 24.**Impianti i trajtimit të ujërave të zeza ..... 6
**Tabela 25.**Karakteristikat për sicilën komponentet e përpunimit të ujërave të ndotura ..... 6
**Tabela 26.** Progresi i punës në GIS ..... 6
**Tabela 27.** Tabela e atributeve për rrjetin e ujit të digjitalizuar në sistemin GIS ..... 6
**Tabela 28.** Top 10 Asetet jo infrastrukturore ..... 7
**Tabela 29.** Përqindja e vlerësimit të aseteve ..... 7
**Tabela 30.** Rrjeti i kanalizimit ..... 7
**Tabela 31.** Pusetat e kanalizimit ..... 7
**Tabela 32.** Projektet e investimeve kapitale ..... 7
**Tabela 33.** Lista e investimeve kapitale ..... 7

## Lista e figurave

**Figura 1.** Matrica e treguesit të Shërbyeshmërisë së aseteve ..... 1
**Figura 2.** Matrica e kritikalitetit të aseteve ..... 1
**Figura 3.** Skema e transportit të ujit nga SP deri në ITU ..... 2
**Figura 4.** Skema e dozimit të kemikateve në procesin e koagulimit dhe të flokulimit ..... 2
**Figura 5.** Skema e funksionimit të filtrave ..... 2
**Figura 6.** Skema e dozimit të klorit në linjën e para-klorimit, dezinfektimit dhe klorimit korigjues ..... 3

## Lista e hartave

**Harta 1.** Zona e shërbimit dhe mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit për vitin 2024 ..... 1
**Harta 2.** Burimet ujore ..... 2
**Harta 3.** Impiantet e trajtimit të ujit të pijes ..... 2
**Harta 4.** Stacionet e pompimit ..... 3
**Harta 5.** Rezervuaret e ujit ..... 3
**Harta 6.** Valvulat operuese ..... 4
**Harta 7.** Valvula ajrimi ..... 4
**Harta 8.** Valvulat reduktuese ..... 4
**Harta 9.** Ujëmatësit në prodhim ..... 4
**Harta 10.** Konsumatorët ..... 4
**Harta 11.** Tabela e atributeve ..... 4
**Harta 12.** Ujëmatësit zonal ..... 5
**Harta 13.** Hidrantët ..... 5
**Harta 14.** Defektet në rrjetin e ujësjellësit ..... 5
**Harta 15.** Tabela e atributeve ..... 5
**Harta 16.** Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit ..... 5
**Harta 17.** Rrjeti i ujërave të ndotura ..... 6
**Harta 18.** Pusetat e kanalizimit ..... 6
**Harta 19.** Defektet në kanalizim ..... 6
**Harta 20.** Atributet për një defekt ..... 6
**Harta 21.** Impanti për trajtimin e ujërave të ndotura ..... 6
**Harta 22.** Rrjeti primar dhe sekondar i ujit ..... 6

Akronimet

| | |
|---|---|
| AKM | Agjencia Kosovare e Metrologjisë |
| ARRU | Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit |
| BRrA | Baza Rregullatore e Aseteve |
| PMA | Plani i Menaxhimit të Aseteve |
| NSH | Niveli i shërbimit |
| KRU | Kompania Rajonale e Ujësjellësit |
| O&M | Operimi dhe Mirëmbajtja |
| ITU | Impianti i Trajtimit të Ujërave |
| ITUZ | Impianti i Trajtimit të ujërave të Ndotura |
| GIS | Sistemi i Informacionit Gjeografik |
| OBSH | Organizata Botërore e Shëndetësisë |
| SP | Stacion i Pompimit |

**Përkufizimet**

**Aktivitetet e shërbimit**: Aktivitetet e identifikueshme individualisht të cilat duhet bërë ndaras në mënyrë që të ofrohen shërbimet për ujë dhe ujëra të zeza, që janë: resurset dhe trajtimi i ujit, distribuimi i ujit, mbledhja e ujërave të zeza, trajtimi i ujërave të zeza dhe trajtimi dhe deponimi/hedhja e llumit.

**Asetet infrastrukturore**: janë ato asete (kryesisht asete nën-tokësore plus digat), të cilat nuk kanë një jetë të fundme dhe të cilat, nëse mirëmbahen në mënyrë të duhur, do të jenë në gjendje që të vazhdojnë të sigurojnë një nivel të paracaktuar të shërbimit për konsumatorë për një kohë të pacaktuar. Sipas Kontabilitetit Rregullator këto asete nuk zhvlerësohen.

**Asetet jo-infrastrukturore**: janë ato asete (kryesisht mbi tokësore), të cilat kanë një jetëgjatësi të fundme dhe prandaj edhe zhvlerësohen përgjatë asaj jetëgjatësie të supozuar dhe mund të zëvendësohen në fund të jetëgjatësisë së tyre.

**Asetet mbi-tokësore**: siç përcaktohet më poshtë si asete "Jo-infrastrukturore". Në përgjithësi këtu përfshihen të gjitha asetet të cilat lehtësisht mund të shihen dhe të inspektohet gjendja e tyre. Këtu përfshihen paisjet që mund të merren si asete nën-tokësore – p.sh. pompat e puseve.

**Asetet nën-tokësore**: siç përcaktohet më poshtë si asete "Infrastrukturore". Në përgjithësi këto janë asete nën tokë, edhe pse digat janë të përfshira në këtë kategori pasi që zakonisht inspektimi pamor nuk është i mundur.

**Baza rregullatore e aseteve (BRrA):** Baza e kapitalit e përdorur në përcaktimin e kufijve të çmimeve. Kjo është vlera e aseteve të KRU e cili fiton një kthim të në investime. Ajo përfaqëson vlerën fillestare të investimeve plus shpenzimet e reja kapitale. Vlera kapitale llogaritet me metodën e zhvlerësimit sipas kostos aktuale.

**Bilanci i furnizimit/ kërkesës**: Hendeku mes furnizimit dhe kërkesës, si përmes kërkesës nga konsumatorët e ri ose kërkesës së shtuar nga konsumatorët ekzistues, e për të cilën kërkesë të ngritur është i nevojshëm investim shtesë për të siguruar që kërkesa për shërbime do të mbulohet.

**Grantet**: Mjetet e dhëna financiare për investime ose për ofrim të shërbimeve në rastet kur shlyerja/ri-pagesa nuk kërkohet.

**Inventari i Aseteve**: Databazë e të gjitha aseteve të ujit dhe aseteve fikse të ujërave të zeza me të cilat një kompani operon. Kjo databazë është e ndryshme, dhe nuk duhet të ngatërrohet me, regjistrin e aseteve që mbahet për qëllime të kontabilitetit. Inventari i aseteve përmban të dhënat bazë të asetit plus gjendjen e asetit, të dhënat për mirëmbajtje dhe kostot.

**Kthimi në kapital**: një kthim "i drejtë", në bazën rregullatore të aseteve të përfaqësuara si të ardhura vjetore dhe rritje e kapitalit nga një investim, e shprehur si përqindje e investimit origjinal.

**Kërkesat për të ardhura**: Kërkesa vjetore për të ardhura të nevojshme për të financuar aktivitetet e KRU, duke përfshirë kthimin në kapital. Këtu përfshihen kostot operative; ripërtëritja e infrastrukturës; zhvlerësimi sipas kostos aktuale; kthimi në BRA dhe sipas përshtatshmërisë edhe shpenzimet tjera.

**Mirëmbajtja kapitale**: Puna e planifikuar e kryer nga KRU për të zëvendësuar dhe riparuar asetet e furnizimit me ujë dhe të ujërave të zeza e për të siguruar një shërbim bazik për konsumatorët.

**Plani i biznesit**: Dokument i cili i paraqitet për miratim Bordit të Drejtorëve, pronarëve të KRU dhe ARRU, përcakton aktivitetet e planifikuara dhe kostot e shoqëruara (kapitale dhe operative), që gjithashtu është pjesë e aplikacioneve tarifore të KRU të cilat parashtrohen në ARRU.

**Rritja kapitale**: Për të rritur dhe ngritur bazën e aseteve përmes niveleve të ngritura të shërbimit dhe/ose zgjerimit të sistemit.

**Shpenzimet operative**: Shpenzime direkte operative që ndërlidhen me ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë: punën; energjinë; kimikatet; materialet harxhuese; shpenzimet; taksat e pakthyeshme dhe shpenzimet e tjera.

# 1. Hyrje

Të gjitha sistemet e ujit dhe ujërave të ndotura janë të përbëra nga asetet, disa nga këto asete janë të padukshme nën-tokësore, e disa të tjera janë asete të dukshme mbi-tokësore. Këto janë komponentet fizike të sistemit dhe mund të përfshijnë: gypat, valvolat, rezervuarët, pompat, puset, objektet e trajtimit dhe cilindo komponent tjetër që bënë pjesë në sistem. Asetet që janë pjesë përbërëse e sistemit të ujësjellësit dhe atij të ujërave të ndotura humbasin vlerë me kalimin e kohës dhe me përkeqësimin e sistemit. Paralelisht me këtë përkeqësim mund të bëhet më e vështirë për të siguruar/ofruar nivelin e shërbimit të dëshiruar nga konsumatorët e kompanisë. Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes do të rriten njësoj sikurse edhe vjetërsia e aseteve.

Ekziston një qasje për menaxhimin e aseteve të sistemit e që mund të ndihmojë kompaninë në marrjen e vendimeve më të mira në menaxhimin e këtyre aseteve të vjetëruara. Kjo qasje quhet menaxhimi i aseteve.

Manuali Ndërkombëtar i Menaxhimit të Infrastrukturës e përcakton qëllimin e menaxhimit të aseteve si; ...arritjen e nivelit të kërkuar të shërbimit, për konsumatorët aktual dhe ata të ardhshëm, në mënyrën më koso-efektive përmes krijimit, përvetësimit, operimit, mirëmbajtjes, rinovimit dhe deponimit/hedhjes të aseteve... Një kompani e ujit dhe e ujërave të ndotura duhet të kujdeset për një sërë arsyesh për menaxhimin e aseteve të saj në një mënyrë me kosto efektive:

- Këto lloje të aseteve përfaqësojnë një investim madhor publik në sektorin e ujit;
- Infrastruktura e drejtuar mirë është e rëndësishme për zhvillimin ekonomik;
- Operimi i duhur dhe mirëmbajtja e kompanisë është esenciale për shëndetin dhe sigurinë publike;
- Asetet e kompanisë ofrojnë një shërbim thelbësor për konsumatorë;
- Menaxhimi i aseteve promovon eficencë dhe inovoacion në operim të sistemit;

Qëllimi i menaxhimit të aseteve është për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të kompanisë ujit dhe ujërave të ndotura. Duke ndihmuar menaxhmentin e kompanisë për të marrë vendime më të mira të mundshme në lidhje me atë se kur një aset i veçantë është më i përshtatshëm për t'u riparuar, zëvendësuar ose për t'u rehabilituar, dhe duke zhvilluar një strategji afat-gjatë të financimit, kompania mund të sigurojë aftësinë e saj për të ofruar nivelin e kërkuar të shërbimit në aspektin afatgjatë.

## 2. Deklarata e nivelit të shërbimeve

KRU "Mitrovica" sh.a është ndërmarrje publike e licencuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU), për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

KRU "Mitrovica" sh.a ka për qëllim të ofrojë shërbime të pandërprera të furnizimit me ujë me kosto të përballueshme duke i përmbushur standardet e OBSH-së, në regjionin e komunave: Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj, Mitrovicë Veriore dhe Zveçan.

**Tabela 1.** Deklarata e nivelit të shërbimeve

| Standardet minimale të shërbimeve | Njësia | Vlerat | Niveli i tanishëm | Caku afatgjatë |
|---|---|---|---|---|
| Kualiteti i ujit (fiziko-kimik dhe bakteriologjik) | Nr. i testeve të dështuara | (Nr. ose %) | Teste Bakteriologjike 0% Dështime Testet fiziko-Kimike 0% Dështime | Asnjë dështim dhe në përputhshmeri me standardet për ujë të pijshëm sipas UA 10/2021 |
| Vazhdimësia e furnizimit me ujë për konsumim njerëzor | Orë në ditë | 24 h/d | 24/ditë | Që të mbahet ky trend |
| Pronat e prekura nga shtypja e ulët në rrjetin shpërndarës të ujit | bar | Min. 1.5 bar Max. 7 bar tek rubineti i konsumatorit | Në rrjetin shpërndarës nuk ka probleme me presionin e ulët | Të vazhdojm me furnizim të rregullt të ujit të pijshëm |
| Mbulueshmëria më shërbime të ujit të pijshëm në zonën e shërbimit | % | 100% | 80% | Të arrijm nivelin 95% |
| Matja e ujit (faturimi i ujit sipas matjes) | % | 100% | 90% | 10% bëjnë pjesë edhe kons.pasiv dhe të paidentifikuar ose fiktiv. Të arrjimë nivelin 100% |
| Verifikimi dhe kontrolli i pajisjeve matëse të ujit | / | / | / | / |
| Shqyrtimi dhe adresimi i ankesave të konsumatorëve | Nr i ankesave të konsumatorëve | 3,071 - Teknike 171- Komerciale | 3071 të realizuara 171 – të përfunduara | Të shqyrëtohen të gjitha ankesat me kohë dhe gjithashtu të rritet niveli i shërbimit ashtu që të kemi sa më pak ankesa |
| Pajisja me leje ujore dhe vendosja/ krijimi i zonave të mbrojtura ujore | / | / | Zona është në kontroll sipas ligjit | Në pajtueshmëri me Legjislacionin përkatës të MMPH |
| Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (rrjetit të kanalizimeve) në zonën e shërbimit | % | 100% | 65% | Të arrihet niveli 80 % |
| Mbulueshmëria me shërbime për përpunimin e ujërave të ndotura | % | 100% | 20% | Të arrihet niveli 90% |
| Kualiteti i ujërave të shkarkimit në mjedisin rrethues/ trupat ujor | / | / | Plotësohen të gjitha kriteret | Daljet janë kryesore që derdhen në lumenjët: Ibër, Sitnicë, Rekë |
| Shpeshtësia e pastrimit të rrjetit të kanalizimit | % | 100% | 80% | Të arrihet pastrimi i rrjetit 100% |

# 3. Menaxhimi i aseteve dhe metodologjia

## 3.1. Përfitimet nga Menaxhimi i Aseteve

Ka shumë përfitime pozitive nga menaxhimi i aseteve. Kompanitë e ujit të cilat plotësisht pranojnë dhe zbatojnë parimet e menaxhimit të aseteve mund të arrijnë shumë ose që të gjitha nga këto përfitime vetëm duke filluar me menaxhimin e aseteve. Përfitimet përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Vendime më të mira operative
- Aftësi më të mëdha për të planifikuar dhe paguar për riparimet dhe zëvendësimet e ardhshme
- Njohuri e shtuar mbi vendndodhjen e aseteve
- Njohuri e shtuar se cilat asete janë kritike për kompaninë dhe cilat nuk janë kritike.
- Operim më efikas
- Komunikim më i mirë me konsumatorë
- Tarifë e bazuar në informata të mira operative në lidhje me koston e vërtetë të nevojshme për mirëmbajtje të asetit.
- Pranueshmëri më e madhe e aplikacioneve tarifore, si për rregullatorin po ashtu edhe për komunitetin
- Identifikimi i projekteve të përmirësimeve kapitale të cilat përmbushin nevojat e vërteta të kompanisë dhe prandaj janë më atraktive për donatorët potencial.

Planifikimi i menaxhimit të aseteve është një mënyrë për të demonstruar te Rregullatori dhe komuniteti që asetet janë të menaxhuara siç duhet dhe se tarifa e ngarkuar do të mbulojë koston e mirëmbajtjes së këtyre aseteve dhe siguron një justifikim të fortë për tarifën.

Për më tepër, ashtu siç u tha më lart, të paturit e një Plani për Menaxhimin e Aseteve (PMA) – produkt i procesit të menaxhimit të aseteve - mund të ofrojë arsyetimin që donatorët dhe institucionet e tjera financiare kërkojnë, kur ata e konsiderojnë të investuarit në një KRU. Investitorët gjithnjë pyesin "përse ju kërkoni të investoni mu në këtë zëvendësim të gypit e jo në këtë tjetrin?"... duke pasur një PMA ajo përgjigjet saktësisht të këtë pyetje.

## 3.2. Korniza Ligjore

Sektori i ujit në Kosovë është i rregulluar në nivelin qendror nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e ujit. Legjislacioni primar i cili siguron autorizimet, përgjegjësitë, mandatin për rregullimin e shërbimeve të ujit në Kosovë të ARRU është ligji nr 05/L – 042. Përmes këtij ligji ARRU-së i jepet mandat për të miratuar dhe vendosur tarifat e shërbimit, aprovuar investimet kapitale dhe për të vendosur e zbatuar standardet minimale të shërbimit për konsumatorë.

Neni 48 i këtij ligji "Shqyrtimi i akteve interne të ofruesve të shërbimeve" liston aktet që duhet të hartohen nga ofruesit e shërbimeve dhe të aprovohen nga Autoriteti, si:

- Planet e Biznesit;
- **Planet e Menaxhimit të Aseteve;**
- Planet afatgjata të investimeve;
- Planet e Menaxhimit të Thatësisë;
- Planet e Furnizimit me Ujë në Situata Emergjente.

Përveç përfitimeve nga ana e konsumatorëve për mbajtjen e dhe ofrimin e nivelit të shërbimit, si dhe përfitimit të KRU-së ku arrihet të bëhet një pasqyrë mbi gjendjen e aseteve, punimi i PMA-së është edhe obligim ligjor ku detyrohen të gjitha KRU-të në Kosovë që t'i punojnë ato, në bazë të udhëzimeve dhe instruksioneve të përcaktuara nga Rregullatori si dhe të praktikave të mira ndërkombëtare që mund të jenë të aplikueshme në Kosovë.

## 3.3. Metodologjia e vlerësimit të aseteve

Janë dy parametra me të cilët mund të bëhet vlerësimi i aseteve. Ato janë:

- Shërbyeshmëria, dhe
- Kritikaliteti

Shërbyeshmëria është koncept që merr për bazë gjendjen e asetit dhe performancën e tij, kurse kritikaliteti është koncept që merr për bazë probabilitetin e dështimit dhe pasojat e dështimit të asetit. Këto dy koncpete, të përshkruara dhe elaboruara në detaje do të paraqiten në pjesët në vazhdim.

### 3.3.1. Shërbyeshmëria e aseteve

Shërbyeshmëria është koncept i rëndësishëm në planifikimin e menaxhimit të aseteve, ajo formon bazën për alokimin e shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale. Në qoftë se një aset është i shërbyeshëm atëherë i njejti nuk kërkon investime, nëse nuk ka shërbyeshmëri atëherë vlen e kundërta, duhet të bëhen investime në të.

Në terma praktike me shërbyeshmëri nënkuptohet kombinimi i **gjendjes** dhe **performancës** së asetit. Deri te ky tregues zakonisht arrihet duke krijuar një proces programues përmes të cilit si për gjendjen e poashtu edhe për performancën e asetit përdoren rangimi nga 1 deri në 5 ([mirë (1) dhe keq (5)]. Pastaj këto rangime shumëzohen ose i shtohen njëra tjetrës përmes të cilit proces arrihet deri te treguesi (indeksi) i shërbyeshmërisë që poashtu janë përbrenda rangimit nga 1 deri në 5.

Gjendja:

1. Pa dështime të imëta dhe përkeqësime të papërfillshme
2. Dështime të imëta dhe/ose përkeqësime të vërejtura, asnjëra nuk ndikon në performancë
3. Dështime dhe përkeqësime të vërejtura por jo aq të rëndësishme që të ndikojnë në performancën aktuale apo në planin afat-shkurtër
4. Dështime të theksuara të vëzhguara ose që janë në zhvillim e sipër e që ka gjasa që të ndikojnë performancën në planin afat-shkurtër (kërkohet renovim/zëvendësim)
5. Gjendje kritike që pengon performancën e duhur ose gjendje e pa-riparueshme (kërkohet zëvendësim i menjëhershëm)

Performanca:

1. E specifikuar dhe dizajnuar sipas standardeve moderne, plotësisht në gjendje për të ofruar nivelin e kërkuar e pa probleme të besueshmërisë
2. E dizajnuar sipas standardeve të vjetëruara dhe/ose tregon disa probleme të vogla të besueshmërisë por ofron shërbimin e kërkuar
3. Gabime me dizajn dhe eficencë të operimeve që nuk pengojnë operacionet normale
4. Shfaq probleme të besueshmërisë dhe aftësisë që ndikojnë në operimet normale
5. Dështon në përmbushjen e kërkesave të besueshmërisë që paraqet një pasqyrë se aseti nuk është në gjendje të ofrojë shërbimin e nevojshëm

| Performanca | Gjendja | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 1 | 1.0 | 1.5 | 2.0 | 2.5 | 3.0 |
| 2 | 1.5 | 2.0 | 2.5 | 3.0 | 3.5 |
| 3 | 2.0 | 2.5 | 3.0 | 3.5 | 4.0 |
| 4 | 2.5 | 3.0 | 3.5 | 4.0 | 4.5 |
| 5 | 3.0 | 3.5 | 4.0 | 4.5 | 5.0 |

**Figura 1.** Matrica e treguesit të Shërbyeshmërisë së aseteve

### 3.3.2. Kritikaliteti i aseteve

Vlerësimi i kritikalitetit kërkon shqyrtimin e mundësisë së dështimit dhe pasojës së dështimit. Asetet që kanë probabilitetin më të madh të dështimit dhe pasojat më të mëdha të ndërlidhura me dështimin do të jenë ato asete që janë më kritiket. Për të filluar me vlerësimin e kritikalitetit mund të përdoret një teknikë e tillë si matrica ranguese, ashtu siç paraqitet në vijim.

Asetet e ardhshme më kritike janë:

- Asetet të cilat kanë probabilitet të lartë të dështimit por me pasoja të ulëta
- Asetet të cilat kanë pasoja të larta mirëpo probabilitet të ulët
- Asetet që kanë probabilitet mesatar dhe pasoja mesatare

Asetet e mbetura që kanë pasoja të ulëta dhe probabilitet të ulët do të jenë asetet më pak kritike.

| Probabiliteti | Pasojat | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| 6 | 6.00 | 12.00 | 18.00 | 24.00 | 30.00 | 36.00 |
| 5 | 5.00 | 10.00 | 15.00 | 20.00 | 25.00 | 30.00 |
| 4 | 4.00 | 8.00 | 12.00 | 16.00 | 20.00 | 24.00 |
| 3 | 3.00 | 6.00 | 9.00 | 12.00 | 15.00 | 18.00 |
| 2 | 2.00 | 4.00 | 6.00 | 8.00 | 10.00 | 12.00 |
| 1 | 1.00 | 2.00 | 3.00 | 4.00 | 5.00 | 6.00 |

**Figura 2.** Matrica e kritikalitetit të aseteve

Në mënyrë që kjo matricë t'i shërbejë qëllimit dhe të jetë e përdorshme së pari duhet vlerësuar probabilitetin e dështimit nga 1 deri 6 e ku me 6 vlerësohet probabiliteti shumë i lartë i dështimit dhe me 1 vlerësohet probabiliteti shumë i ulët i dështimit. Pastaj lokalizohet numri në matricë, aty ku gërshetohen rreshti dhe kolona e vlerësuar. Ai numër (gërshetimi i dy treguesve tjerë, pra i probabilitetit dhe pasojës) paraqet treguesin e kritikalitetit për atë aset. Edhe kjo matricë e prezantuar si shembull është me ngjyra, në mënyrë që kur e njëjta të përdoret në ndonjë tabelë shumë voluminoze të aseteve, asetet kritike të mund të identifikohen më lehtë përmes ngjyrës, në këtë rast ngjyra e kuqe është e barabartë me kritike.

**Tabela 2.** Përshkrimi mbi vlerësimin e rangimit të probabilitetit të dështimit të asetit

| Rangimi i probalbilitetit të dështimit të asetit | | |
|---|---|---|
| Niveli rangues | Përshkrimi | Faktorët |
| 1 | Pothuajse asnjë gjasë të dështimit | Aset i ri pa asnjë faktorë të jashtëm të rrezikshm |
| 2 | Mundësi e vogël e dështimit | Ka filluar të tregojë shenja të përkeqësimit. Pothuajse asnjë faktorë të jashtëm të rrezikshëm. |
| 3 | Ka ndonjë mundësi të dështimit por nuk ka gjasa që të dështojë në planin afatshkurtër | Nuk është në gjendjen më të mirë të mundshme por i riparuar mirë. Vetëm në raste të ndikimit nga faktorët e jashtëm të rrezikshëm. |
| 4 | Me gjasë të dështimit në planin afatshkurtër | Për momentin në gjendje operative por i vjetër dhe në fund të jetëgjatësisë së tij të pritshme. Pa faktorë të jashtëm të rrezikshëm. |
| 5 | Me gjasa të dështimit në 12 muajt e ardhshëm | Histori të rregullt të dështimeve, por jo të shpeshta. Gjendje të dobët. Faktorë të jashtëm të rrezikshëm. |
| 6 | Me shumë gjasa të dështimit në të ardhmen e afërt | Histori të shpeshta të dështimit. Në gjendje të dobët. Faktorë të shumtë të jashtëm me rrezikshmëri. |

Sa i përket pasojave të dështimit të asetit edhe ato duhet të rangohen nga shkalla 1 deri në 6, ku numri 1 paraqet asetin që ka pasojë të vogël kurse rangimi 6 paraqet asetin me pasoja më të mëdha.

**Tabela 3.** Vlerësimi i aseteve infrastrukturore (nëntokësore) - Ujësjellës

| Nr | Emri i asetit | Komuna | Materiali | Diametri | Gjatësia | Viti Instalimit | Nr. Defekteve | Jetëgjatësia | Viti amortizimit | Periudha e mbetur | Probabilitet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rrjeti i ujit ne Rekë-Tunell | Mitrovicë | AC | 315 | 2900 | 1984 | 36 | 35 | 2019 | -5 | 6 |
| 2 | Rrjet i ujit "Rr. Ukshin Kovaqica" | Mitrovicë | ZN | 3'' | 200 | 1974 | 30 | 35 | 2009 | -15 | 6 |
| 3 | Rrjet i ujit "Rr. Mbretresha Teuta" | Mitrovicë | ZN | 75 | 300 | 1985 | 33 | 35 | 2020 | -4 | 6 |
| 4 | Rrjet i ujit"Rr.Qazim Cimili" | Mitrovicë | ZN | 75 | 300 | 1985 | 37 | 35 | 2020 | -4 | 5 |
| 5 | Rrjet i ujit St i pom "Mutfaja" deri te rezervuari ne Studime | Vushtrri | AC | 300 | 5000 | 1964 | 33 | 35 | 1999 | -25 | 5 |
| 6 | Rrjet i ujit RR.Arsim Muzaqi | Vushtrri | ZN | 32 - 40 | 300 | 1982 | 29 | 35 | 2017 | -6 | 5 |
| 7 | Rrjet i ujit Ne f.sh Akrashticë | Vushtrri | PVC | 90 | 4150 | 1994 | 26 | 35 | 2029 | 5 | 5 |
| 8 | Rrjet i ujit Rruga Krujes | Vushtrri | PVC | 50 | 270 | 1996 | 35 | 35 | 2031 | 7 | 5 |
| 9 | Rrjet i ujit Rr."Naip dhe Fatmir Pashica" | Vushtrri | ZN | 40 | 500 | 1987 | 20 | 35 | 2022 | -2 | 5 |
| 10 | f.sh Delak RR "Muharrem Kacanolli"te varrezat | Vushtrri | PE | 23-32-40 | 400 | 1995 | 28 | 35 | 2030 | 6 | 5 |
| 11 | Rrjet i ujit Rr."2 Maji" | Vushtrri | ZN | 2'' | 270 | 1987 | 25 | 35 | 2022 | -2 | 5 |
| 12 | Rrjet i ujit Lagja 2 Rr."28 Nentori" | Skenderaj | PVC | 110 | 800 | 1989 | 20 | 35 | 2024 | 0 | 5 |
| 13 | Rrjet i ujit Lagja 1 Rr."Ahmet Delia" | Skenderaj | AC | 200 | 300 | 1985 | 23 | 35 | 2020 | -4 | 5 |
| 14 | Rrjet i ujit Lagja 2 Rr."Rexhep Malaj" | Skenderaj | PVC | 90 | 600 | 1986 | 19 | 35 | 2021 | -3 | 5 |

**Tabela 4.** Vlerësimi i aseteve infrastrukturore (nëntokësore) – Kanalizim

| Nr | Emri i asetit | Komuna | Diameter | Material | Gjatësia | Nr. Defekteve | Probabilite |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rrjet i kanalizimit "Rr.Nexhip Dragaj" | Mitrovicë | Ø 200 - 300 | AC | 350 | 100 | |
| 2 | Rrjet i kanalizimit "Rr Ukshin Kovaqica" | Mitrovicë | Ø 300 | AC | 500 | 150 | |
| 3 | Rrjet i kanalizimit "Rr Mbretresha Teuta" | Mitrovicë | Ø 400 | AC - BE | 1000 | 80 | |
| 4 | Rrjet i kanalizimit<br>Lagja 2<br>(Te banesat e socialit) | Skenderaj | Ø 110 | AC | 200 | 50 | |

# 4. Gjendjes ekzistuese e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura

## 4.1. Shërbimet e ujësjellësit

### 4.1.1. Zona e shërbimit dhe numri i konsumatorëve

KRU"Mitrovica" furnizon me ujë të pijshëm konsumatorët në këto komuna:

1. Komunën e Mitrovicës Jugore me fshatra
2. Komunën e Mitrovicës Veriore me fshatra
3. Komunën e Vushtrrisë me fshatra
4. Komunën e Zveçanit me fshatra
5. Komunën e Skënderajit me fshatra
6. Komunën e Zubin Potokut - fshati Qabër

Furnizimi me ujë të pijshëm i konsumatorëve bëhet 24 orë pa ndërprerje.

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve është rritur nga viti në vit dhe për vitin 2024, numri i konsumatorëve ka arritur në total: 51,554.

Vërejtje: Komuna e Mitrovicës së Veriut dhe e Zveçanit e marrin ujin e përpunuar mga KRU"Mitrovica"-ITU"Shipol" ndërsa numrin e konsumatorëve në këto dy komuna nuk e kemi të njohur.

Faturimi bëhet në bazë të ujëmatësve të vendosur për matjen e ujit për pjesën veriore.

**Tabela 5.** Numri i konsumatorëve sipas Komunave për vitin 2024

| Nr | Komuna | Numri i konsumatorëve me ujëmatës | Numri i konsumatorëve pa ujëmatës (Paushall) | Total |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mitrovicë e Jugut | 22,192 | 1,173 | 23,365 |
| 2 | Vushtrri | 18,559 | 221 | 18,780 |
| 3 | Skënderaj | 9,371 | 34 | 9,405 |
| 4 | Mitrovicë Veriore | 4 | 0 | 4 |
| 5 | Zveçan | N/A | N/A | N/A |
| 6 | Zubin Potoku-Qabër | N/A | N/A | N/A |
| Total: | | 50,126 | 1,428 | 51,554 |




**Harta 1.** Zona e shërbimit dhe mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit për vitin 2024

### 4.1.2. Burimet e ujit

KRU"Mitrovica" sh.a furnizohet me ujë të papërpunuar nga një burim i ujit:

1. Furnizimi me ujë të pa trajtuar bëhet nga Liqeni i Ujmanit (Gazivodes), përmes Knalit të Ibër – Lepencit që furnizohen Impiantet e përpunimit të ujit të pijeshëm ITU Shipol dhe ITU Balincë. ITU Shipol furnizohet me ujë të papërpunuar nga Kanali i Ibër-Lepecit në fshatin Lushtë, Komuna e Mitrovicës së Jugut me anë të pompave gjerë në ITU Shipol, ndërsa ITU Balinc furnizohet me ujë të papërpunuar nga Kanali i Ibër-Lepencit në fshatin Balincë drejtëpërdrejt ose me rënje të lirë gjerë në ITU Balincë.

   Me ndërtimin e digës në lumin Ibër është formua Liqeni i Ujmanit (Gazivodes) me siperfaqe 7 $km^2$, ndërsa sipërfaqja e digës është 1.060 $km^2$ dhe me rrjedhje mesatare 13,5 m3/sek.
   Vëllimi i akumulacionit në Liqenin e Ujmanit është 370 milion $m^3$ ujë, ndërsa vëllimi shfrytëzues është 350 milion $m^3$ ujë.

**Tabela 6.** Burimet ujore

| Nr | Emri i burimit | x | y | z | Komuna | Kapaciteti (l/s) | Lloji i burimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Liqeni i Ujëmanit | 7470571.489 | 4755158.735 | 689 | Zubin Potok | 13,500 | Akumulues |




**Harta 2.** Burimet ujore

### 4.1.1. Impiantet e përpunimit të ujit

KRU"Mitrovica" ka tri fabrika të përpunimit të ujit të pijshëm ku momentalisht në punë janë vetëm dy.

1. Fabrika e vjetër e përpunimit të ujit në Shipol me kapacitet 450-550l/s (nga viti 2014 është jashtë përdorimit – është e ndërtuar në vitin 1978).
2. Fabrika e re e përpunimit të ujit në Shipol me kapacitet 750l/s në funksion nga viti 2014.
3. Fabrika e përpunimit të ujit në Balincë – Vushtrri me kapacitet 350l/s (momentalisht punon me kapacitet të përgjysmuar ) e lëshuar në punë nga viti 2016.

**Tabela 7.** Impiantet e përpunimit të ujit

| Nr | Emri i FPU | x | y | z | Komuna | Viti i futjes në operim | Kapaciteti (l/s) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | FPU Shipol(e vjeter-jashtë funksionit) | 7486669.025 | 4746538.567 | 585 | Mitrovicë | 1978 | 450-550l/s |
| 2 | FPU Shipol | 7486608.039 | 4746537.464 | 585 | Mitrovicë | 2014 | 750l/s |
| 3 | FPU Balincë | 7490748.571 | 4741734.724 | 552 | Vushtrri | 2016 | 350l/s |




**Harta 3.** Impiantet e trajtimit të ujit të pijes

Në tabelën 8, e paraqitur në vazhdim është përshkruar zingjiri i proceseve të funksionimit për brenda "ITU Shipol" ndërsa disa kolona nuk kanë përshkrim për arsye që deri aty përfundon struktura operative e sistemit.

**Tabela 8.** Karakteristikat për secilën komponent/ hap të përpunimit të ujit ITU "Shipol"

| Nr | ITU"Shipol" | Fazat e trajtimit të ujit | Aeratori | Paisjet e dozimit | Funderruesi | Stacioni i filtrimit | Sistemi i dezinfektimit | Sistemi automatik i kontrollit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Dhoma me valvulë për rregullimin e izolimit dhe të rrjedhes – S01 | Trajtimi fizik i ujit | Për shkak të pasurimit të ujit me oksigjen në rrjedhe të kanalit nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Kontinierat me klor | Njësia sendimentue - sve - S03 fundrrimi imbetjeve të llumit të ndar nga uji. | Njësia e filtrave (10 njësi) | Dezinfektimi i ujit me ozon | Kontrollimi dhe operimi përmes programit logjik të kontrolles PLS-SCADA SYSTEM. |
| 2 | Dhomat me njëhësor për ujin e papërpunuar S02,S13 | Para ozonimi dhe klorimi paraprak | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Linjat transportuese të klorit deri të injektoret | Njësia sendimentue -sve - S04 fundrrimi i mbetjeve të llumit të ndar nga uji. | Sistemi i funksionimit konvencional | Prodhimi i ozonit nga ajri përmes gjeneratorit të ozonit | Kontrollimi dhe operimi automatik i dozimit të ujit me klor |
| 3 | Fundërrimi (Sendimentimi) i grumbullimit dhe shtresimit – S03,S04,S05 | Koaguli me FeCl3 apo Al2(SO4) | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Paisjet e klorit nën vakum | Njësia sendimentue sve - S05 fundrrimi imbetjeve të llumit të ndar nga uji. | Filtrat e nivelit të lartë të rërës të fushave filtruese | Kompresori për furnizim të gjeneratorit me ajër | Kontrollimi dhe operimi automatik i dezinfektimit të ujit me ozon |
| 4 | Filtrat e nivelit të lartë të rërës – S06 | Flokulimi mepolielek trol-itanionik | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Rregullatoret e dozimit të klorit | Njësia e sendimentimit S010 e ujit pasprocesit të filtrimit të ujit | Sistemi i larjes,rapid | Linja transportuese e ozonit në kontakt me ujin | Kontrollimi dhe operimi automatik i filtrave |
| 5 | Vaska për deponimin e ujit të kthyer – S010 | Sendimenti -mi me llamella | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Iniektoret | Dendësuesit e llumit të rëndësës – S11 | Funksionimi ipompave automatik | Tanku i mbushur me uji për oksidim/dezinfe -ktim | Kontrollimi dhe operimi automatik i dozimit te ujit me koagulant klorur ferrik |
| 6 | Vaska me kontakt të klorit – S08 | Filtrat eshkallës së Lartë të rërës | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Pompat klorizuese të ujit | Njësia e trajtimit të llumit - B01 | Funksionimi i kompresorave të ajrit | Dezinfektimi i ujit me klor | Kontrollimi dhe operimi automatik i dozimit te ujit me koagulant sulfat te aluminit |
| 7 | Dhoma me njëhësor të rrjedhes së ujit të papërpunuar - S09 | Post-klorimi | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Paneli operues | Funderrimi i mbetjeve të FeCl3 në B02 | Galeria e paisieve elektromaqineri ke | Paisjet e dezinfektimit – B03 | Kontrollimi dhe operimi automatik i dozimit te ujit me polielektrolit |
| 8 | Vaska mbajtëse e ujit me filtër të shkallës së lartë – S07 | Linja për trajtimin e llumit | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Rezervuaret deponues të koagulanteve | Funderrimi i mbetjeve të Al2(SO4)3 në B02 | Pompat e ujit për pastrimin e filtrave | Paraklorim/oksi -dim | Kontrollimi dhe operimi automatik i njësis të sendimetuesit |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Dendësuesit e llumit të rëndësës – S11 | | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Pompat e dozimit të koagulanteve | | Pompat e ujit (servisimit) | Dezinfektim kryesor - S08 | Kontrollimi dhe operimi automatik të njësia e trajtimit të llumit |
| 10 | Dhoma me valvulën me në hyrje të rezevuarit me uji të papërpunuar – S12 | | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Linja transportuese e dozimit | | Filtrat e nivelit të lartë të rërës – S06 | Kontroll e dozimit | Kontrollimi dhe operimi automatik i i portave hapje dhe mbyllje të njësit trajtuese të ujit |
| 11 | Dhoma me njëhësor për rrjedhen e ujit të papërpunuar në ipiantin ekzistues – S13 | | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Paneli operues | | Vaska mbajtëse e ujit me filtër të shkallës së lartë – S07 | Mundesi e operimit/dozimi automatik dhe manuel | Kontrollimi dhe operimi automatik i mekanizmit të pastrimit të ujit nga materialet e forta |
| 12 | Dhoma e rezervuarit me derivate – S14 | | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Apartura për pregaditjen e tretjeve të polielektrolitit | | Vaska për deponimin e ujit të kthyer – S010 | Oksidimi i Fe,Mn.Al me klor | Kontrollimi dhe operimi automatik i i pompave në stacionin Lushta |
| 13 | Ndërtesa për heqien e ujit nga llumi – B01 | | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Pompat dozuese | | Paneli operues automatik dhe manual | Oksidimi i Fe,Mn.Al me Ozon | Kontrollimi dhe operimi automatik i i valvulave |
| 14 | Ndërtesa kimike – B02 | | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Linja transportuese e dozimit | | | | Kontrollimi dhe operimi automatik i rregullimit të kohës për pastrimin e filtrave |
| 15 | Ndërtesa e klorit – B03, ndërtesa e transformatorit –B04, ndërtesa e administrimit-B05, ndërtesa për ruajtje dhe puntori – B06/B07 si dhe laboratori | | Nuk është pa e nevojshme faza e ajrimit të ujit në ITU Shipol. | Paneli operues | | | | |

**Tabela 9.** Karakteristikat për secilën komponent/ hap të përpunimit të ujit ITU "Balincë"

| Nr | ITU "BALINCE" | Hapat e përpunimit të ujit | Aeratori | Paisjet e dozimit | Fundrruesi | Stacioni i filtrimit | Sistemi i dezinefektimit | Sistemi automatik i kontrollit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Objekti Kimkaleve | Kaptazha | Kaskadat e ajrimit | Rez. kemikaleve | Rez i fundrrimit | 6-Fusha filtruese | Me klor | SCADA SISTEM |
| 2 | Objekti klorit | Kaskadat | Kaskadat e filtrit-1 | Pompat shtyese | Pas pastrimit të fushave pastruese | Mediumi KUARC dhe ANTRACID | Klori i gazët | Manipulon hyrje daljet e ujit |
| 3 | Objekti i trafos | Rez. i dozimit | Kaskadat e filtrit-2 | Rez. i dozimit | Riciklimi | Shperlarja me AJER-BLLOVERAT | Paisjet e dozimit | Manipulon hyrje daljet e ujit |
| 4 | Objekti i trajtimit të ujit | Rez. i koagulimit | Kaskadat e filtrit-3 | Rez. i koagulimit | Rezervuaret e flokulimit | Shpërlarja me ujë nën shtypje | Rez. i dozimit | Manipulim me dozat e klorit |
| 5 | Rezervuaret | Rez. e flokulimit | Kaskadat e filtrit-4 | Rez. e flokulimit | Rezervuaret e flokulimit | Rezervuaret e flokulimit | Rez. i koagulimit | Manipulim me dozim të kimikaleve |
| 6 | Galeria e pompave | Rez. sendimentit | Kaskadat e filtrit-5 | Rez. sendimentit | Rez. sendimentit | Rezervuaret e flokulimit | Rez. e flokulimit | Manipulim me pompat kryesore shtytese |
| 7 | Objekti i paisjeve elektronike | Fushat filtruese | Kaskadat e filtrit-6 | Fushat filtruese | Fushat filtruese | Hinka grumbulluese sendimenteve | Rez. sendimentit | Manipulim me sistemin e kaptazhave |
| 8 | Objekti i zyreve | Tanku thithës | Tanku thithës-gypat e ajrimi | Tanku thithës | Tanku thithës | Rezervuari sendimentues | Fushat filtruese | Manipulim me bllovera dhe pompa |

**Furnizimi i ITU në Shipol** - me ujë të pa përpunuar bëhet nga penda e Ujimanit, ruhet në liqenin artificial të Pridvoricës, pastaj transmetohet në kanalin e ujitjes të Ibër-Lepencit. Sipas analizave laboratorike të ujit të papërpunuar, parametrat problematik janë: turbullirat, vlera e lartë e karbonit organik, koncentrimi i nitrateve dhe bakteri koliform. Këto vlera tregojnë qartë se uji i papërpunuar nuk është i gatshëm për t'u konsumuar.

**Fazat e procesit të trajtimit** - ky proces përbëhet nga fazat e mëposhtme:

Linja e ujit përfshinë trajtimin mekanik në SP dhe trajtimin kimik dhe mekanik mbrenda ITU-së.

**Trajtimi tek SP** - faza e parë e trajtimit fillon me rastin e kalimit të ujit nga kanali në strukturat thithëse të stacionit te pompimit. Për këtë qellim janë të vendosura dy rrjeta vetpastruese me hapsirë prej 6mm, që shërbejnë për ndaljen e mbeturinave prezente në ujë.

Ky proces monitorohet për gjatë tërë kohës dhe funksionojn në menyrë automatike, të dirigjuar nga matësit e nivelit para portave dhe pas tyre.



**Figura 3.** Skema e transportit të ujit nga SP deri në ITU

**Trajtimi brenda ITU-së**

1. Para ozonimi dhe klorimi paraprak,
2. Koagulimi me FeCl3 apo Al2(SO4)3 ,
3. Flokulimi me polimer anionik,
4. Sedimentuesit me llamella,
5. Filtrat e shkallës së lartë të rërës,
6. Post-klorimi,
7. Linja e llumit e cila përfshin: Rëndesa e trashësisë së llumit - Centrifugimi i kullimit

**Linja e ujit - Para-ozonimi /para-klorimi si hap i parë**

Futja e ozonit në ujë ka për qëllim ta zbres nivelin e materies organike, t'i shkatërrojë organizmat planktone që vijnë si rezultat i zhvillimit të algave, për ta përmirësuar procesin e koagulimit dhe flokulimit dhe si pasojë fundërrimin e grimcave. Ozoni i zbërthen zinxhirët e molekulave të mëdha në blloqe të vogla. Këto molekula të vogla pastaj janë zakonisht më pak bio-degraduese dhe më pak të rrezikshme. Ozoni me kapacitetin e tij të fortë dezinfektues dhe padyshim me nivel më të ulët të dezifenktimit ndaj produkteve anësore(krahasuar me dezinfektuesit tjerë) është oksidanti i zgjedhur për ITU në Shipol.

Ozoni do të furnizohet duke përdorur njësitë gjeneruese brenda Impiantit dhe duke i futur në ujë përmes difuzorëve të vendosur në të dy tanket, për linjen e Impiantit të vjeter dhe Impiantit të ri.

Klorimi është një dozë alternative në fillim të procesit në vend të ozonit, të paktën kohë pas kohe, për t'u siguruar për sigurinë mikrobiologjike të filtrave dhe që ta limitojë zhvillimin e algave në seksione të caktuara. Gjeneratori i ozonit është në punë aktive dhe kryen procesin e trajtimit të ujit në fazen e oksidimit dhe dezinfektim paraprak.

**Objekti B02 (njësia e deponimit të kemikaleve dhe pompave të polielektrolitit anionik)**

Në objektin B02 janë të deponuara kemikatet për trajtimin si: kloruri ferrik, sulfati i aluminit, polielektrolitet të cilat përdoren në procesin e koagulimit, flokulimit, sendimentim dhe pompat dozuese të këtyre kemikaleve.

**Pastrimi (koagulimi, flokulimi dhe sendimentimi)**

Hapi i pastrimit ka për qëllim ta reduktojë turbullimin e ujit që bëhet nga trupat e ngurtë të pezulluar në ujin e papërpunuar. Për këtë qëllim duhet të aplikojmë trajtimin kimik në mënyrë që këto trupa të ngurta të jenë mjaftueshëm të mëdha për t'u fundërruar.

Koagulanti është substance që shtohet në mënyrë që t'i destabilizojmë koloidet që janë prezentë në ujë. Ne duhet të përdorim përzierje homogjene të koagulanteve dhe ujit brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore.Koagulantët që janë përdorë në ITU Shipol janë kloruri ferrik dhe sulfati i aluminit. Grimcat e formuara duhet të zgjerohen në mënyrë që të fundërrohen dhe prandaj trajtimi kërkon aplikimin e polielektrolitëve anionikë.

Në këtë hap të flokulimit është e nevojshme përzierja e ngadalshme. Procesi i flokulimit përbehet nga tre hapa, të cilët realizohen në tri tanke të vëllimeve të ndryshme. Shpejtësia e përzierjes bie duke u nisur nga pusi i parë tek i dyti dhe pastaj tek i treti.

Polielektroliti anionik dozohet në kthinën e parë dhe të dytë. Për këtë qëllim përdoren 0.1 – 0.2% të solucionit të polielektroliteve të përgatitur në njësitë e automatizuara për përgatitjen e polimerit. Sedimentimi kryhet në sedimentuesit lamellar, të cilet ofrojnë efikasitet të lartë në menjanimin e papastërtive në këtë fazë të trajtimit. Grimcat e formuara në procesin e flokulimit mbahen nga ana e llamelave sipërfaqësore dhe qëndrojnë në fund të pastruesit. Llumi i fundërruar mblidhet me gërryerës lëvizës në fund/pjesën e poshtme dhe largohet nga aty duke përdorur pompat e llumit deri tek dendësuesit.



**Figura 4.** Skema e dozimit të kemikateve në procesin e koagulimit dhe të flokulimit

Për pastrimin e ujit në njësinë e koagulimit, flokulimit dhe sendimentimit përdoren materjet kimike të klorurit ferrik dhe sulfatin e aluminit varsisht prej kritereve të ujit të pa përpunuar dhe efektshmerin me të mirë të koagulantit i cili e ka treguar në periudha të caktuara. Në këtë fazë të trajtimit të ujit maten online (drejtëpërdrejt) nga SCADA 4 (katër) parametra të ujit të papërpunuar. Parametrat e ujit të cilët maten në këtë njësi jan: amoniumi, nitratet, teperatura, oksigjeni, conditiviteti.

**Filtrimi**

Në drejtim të rrymës së njësisë se sedimentimit, uji i pastruar i nënshtrohet trajtimit të filtrimit në mënyrë që të pastrohet uji deri në nivelin e dëshiruar të gatshëm për konsumim nga njerëzit. Uji rrjedh përmes mediumit të rërës dhe grimcat eventuale do të mbesin në medium.

Kur të shteren filtrat, operatori fillon t'i lajë filtrat, proces ky i cili është i automatizuar. Çdo filtër është i pajisur me senzor nivelor. Niveli i ujit do të kontrollohet duke përdorur valvulen rregullues në dalje të tubit. Cilësia e ujit rrjedhës monitorohet me matësin e turbullirës në rezervarin deponues për ri-pastrimin e ujit. Me rritjen e nivelit të ujit, valvula kontrolluese e rrjedhës në dalje do të jetë më e hapur, dhe pastaj kur niveli e arrin vlerën e nivelit maksimal, operatori fillon sekuencat e larjes.

Maksimum dy filtra mund të jenë jashtë operimit. Turbullimi në efluentë duhet të jetë më pak se 0.5 NTU. Pas filtrimit, uji rrjedh deri në tankun e magazinimit për ripastrim, vëllimi i të cilit është i mjaftueshëm për të furnizuar ujë për dy cikle larëse dhe për nevojat e ITU Shipol.




**Figura 5.** Skema e funksionimit të filtrave

Nga njësia e filtrave në mënyrë të drejtëpërdrejt (online) matët niveli i ujit në rezervuar dhe turbiditeti i ujit të filtruar. Janë dy senzorë të cilët shërbejn njëri për matjen e pH-së të ujit në rezervuar dhe tjetri bën matjen e NTU-së.

### 4.1.2. Sistemet e dezinfektimit

Dezinfektimi është faza finale e trajtimit para se uji i pijshëm të distribuohet. Dezinfektimi i largon të gjithë mikroorganizmat patogjen nga uji. Një normë e lirë nga klori prej 0.5mg/l për një kohë prej 30 minutash tek një pH me më pak se 8 është e mjaftueshme për t'i larguar bakteret patogjene dhe viruset poliomelie. Për qëllim të dezinfektimit përdoret gazi i klorit.

Në mënyrë që të sigurohet koha e kontaktit për procesin e dezinfektimit, uji rrjedh përmes tankut me kontakt klori në të cilin ka vëllim të mjaftueshëm për një kohë kontakti prej 30 minutash. Klori dozohet në hyrje të tankut të kontaktit me klor.

Klori dozohet sipas rrjedhës së ujit. Doza duhet të jetë në normën prej 0.5-0.7 mg/l. Nga tanku i klorit uji pastaj rrjedh në rezervuarin e ujit. Pak klor do të shpenzohet në rezervuarin e ujit, prandaj ne duhet të shtojmë klor në ujë në mënyrë që të dezinfektohet deri në fund tek- përdoruesi. Është edhe vendi i dytë i dozimit pas rezervarit të ujit, ku klori do të dozohet sipas matjeve të klorit rezidual në rezervuarin e ujit.

Në dalje të rezervuarit, përqendrimi i klorit duhet të jetë në normën 0.1-0.5 mg/l në mënyrë që të kemi klor për dezinfektimin e rezervarit të ujit, dhe pas rezervarit dozojmë klorin në mënyrë që të kemi pak klor edhe në rrjetin e tubave. Pas dozës së dytë përqendrimi i klorit duhet të jetë 0.5 mg/l.




**Figura 6.** Skema e dozimit të klorit në linjën e para-klorimit, dezinfektimit dhe klorimit korigjues

**Laboratori**

Laboratori është i paisur me apartur për analizimin e parametrave fiziko-kimik dhe bakterologjik. Laboratori është i pajisur ashtu që testet dhe matjet të mund të kryhen në mënyrë të sigurt dhe në shkallën e dëshiruar të ndjeshmërisë.

Për momentin në laboratorin e ITU-së në Shipol bëhen analizat fiziko-kimike të ujit të patrajtuar dhe ujit të trajtuar. Këto analiza bëhen çdo 4 orë, që do të thotë 6 herë brenda 24 orëve. Në këto analiza përfshihen: era, shija, turbiditeti, ngjyra, shkalla Co-Pt, vlera e pH, shpenzimi i KMn04, klori i lirë, kloruret, amoniaku, nitratet, nitritet, hekuri, mangani, alumini dhe përçushmëria elektrike.

Në të gjitha analizat e punuara në laboratorin e fabrikës, rezultatet kanë treguar se parametrat fiziko-kimik të cekur me lart kanë rezultuar brenda kufijve të lejuar për ujë të pijshëm sipas UA nr. 16/2012 dhe direktivave të BE-së.

**Tabela 10.** Lista e pajisjeve në FPU Shipol

| Përshkrimi **i asetit** | | Fuqi (P) KW | Tensioni (U) V | Sasia e aseteve |
|---|---|---|---|---|
| OBJEKTI BO2 TE ALUMIN SULFATI | | | | |
| **Elektro motorr** | **M-601,606** | 0.37 | 380 | **6** |
| **Përzirsat** | **M-611,612** | 1.5 | 380 | **2** |
| **Elektro motorr** | **M-21,23,25** | 0.55 | 380 | **4** |
| **Pomp e dozimit** | **P-607,608,609,610** | 0.37 | 230 | **4** |
| **Ventilatorë** | **B-02** | 0.34 | 230 | **4** |
| **Elektro motorr** | **M-1,2** | 0.18 | 380 | **2** |
| OBJEKTI I KLORIT | | | | |
| **Pomp e klorit** | **M-418,419,420** | 1.5 | 380 | **3** |
| **Pomp e klorit** | **M-421,422,423** | 2.2 | 380 | **3** |
| **Vinqi i klorit** | **M-1** | 0.74 | 380 | **1** |
| **Vinqi i klorit** | **M-2** | 3.0 | 380 | **1** |
| **Elektro motorr i ventillimit** | **M-1** | 1.5 | 380 | **1** |
| **Elektro motorr i ventillimit** | **M-2,3,4,5** | 0.75 | 380 | **4** |
| OBJEKTI TE FLOGULATORET (FUSHAT) | | | | |
| **Valvulë me rrymë** | **CV-102** | 0.75 | 380 | **1** |
| **Valvulë me rrymë** | **CV-13** | 0.1 | 380 | **1** |
| **Valvulë me rrymë** | **CV-104** | 0.1 | 380 | **1** |
| **Valvulë me rrymë** | **CV-105** | 0.75 | 380 | **1** |
| **Motorr** | **M-201,202,203** | 0.4 | 380 | **3** |
| **Valvulë me rrymë** | **CV-301,302,303** | 1 | 380 | **3** |
| **Motorr** | **M-204,205,206** | 1.1 | 380 | **3** |
| **Motorr** | **M-207,208,212** | 0.75 | 380 | **3** |
| **Motorr** | **M-213,217,218** | 0.75 | 380 | **3** |
| **Motorr** | **M-209,210,211** | 1.1 | 380 | **3** |
| **Motorr** | **M-214,215,216** | 1.1 | 380 | **3** |
| **Motorr** | **M-217,218** | 1.1 | 380 | **2** |
| **Motorr** | **M-304,305,306** | 0.75 | 380 | **3** |
| **Motorr** | **M-301,302** | 3.1 | 380 | **2** |
| **Motorr** | **M-309** | 0.37 | 380 | **1** |
| **Motorr** | **M-304,305,306** | 0.12 | 380 | **3** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| FILTËRAT | | | | | |
| Motorr | perzirsat | M-701 | 4 | 380 | 1 |
| Motorr | perzirsat | M-702 | 3 | 380 | 1 |
